



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT, BERAT,
ELBASAN, KORÇË

Nr. ____ .prot

Berat, më . 12.2023

Lënda: Kthim përgjigje!

BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Për dajeni

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Tiranë

Në përgjigje të " Kërkesës për Bashkëpunim " përcjell nga institucioni Juaj me Nr.6599 Prot. Dt.05.12.2023, regjistruar në Tonën me Nr.1302Prot. Dt.07.12.2023 , si dhe në zbatim të ligjit Nr. 10433, Dt. 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjit Nr. 10431, Dt. 9.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" të ndryshuar, ligjit Nr.10448, Dt. 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit" të ndryshuar, ligjit Nr.10463, Dt. 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" të ndryshuar, si dhe VKM, Nr. 568, Dt. 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit". Ju bëjmë me dije se : Subjekti ANSOIL sh.p.k (si e theksoni dhe Ju) është I pajisur me Leje Mjedisi tipi B me datë nxjerrje 23.02.2022. Theksojmë se procedurë për marrjen e saj është dhe zhvillimi i dëgjësës me publikun. Dëgjesa është zhvilluar në Dt.27.10.2021 dhe referuar dokumentacionit që disponojme pjesmarrës në takim kanë qënë , Kryeplaku i zones, përfaqësuar nga NJQV-ja Maliq, Administratore e Njesisë Administrative Libonik dhe banorë të zonës.Në Dt.15.12.2023, Sektori I Inspektimit Mjedisor, ushtoj inspektim të rastësishëm. Në momentin e inspektimit subjekti nuk po kryente aktivitet dhe nga dokumentat e vëna në dispozicion, nuk u konstatuan shkelje të kushteve të Lejes së Mjedisit. Në respektim të nenit 6 Parimi I proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit, nenit 45 Mbajtja dhe njoftimi I procesverbalit, nenit 46 Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar, të ligjit Nr. 10433, Dt. 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" subjektit iu la detyrë të kryejë matjet me laborator të akredituar, sipas kushtit 7.1 të Lejes së Mjedisit, ku i kërkohet "Matje të substancave NOx me kusht që vlerat të shkarkimeve të jenë caktuar, CO, pluhuri total, TOC, HCL, HF, SO2" me interpretimet përkatëse, dhe një kopje ta dorëzojë pranë ARM - së Berat/Elbasan/Korçë brenda datës 10.01.2024, pasi institucioni ynë nuk disponon pajisje/staf të çertifikuar/akredituar , për kryerjen e matjeve . Në përfundim të afateve të vendosura do Tju njoftojmë për masat e marra.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtor i Komanduar i ARM-së
Berat/Elbasan/Korçë
Dritan METAJ

Adresa: Lagja “30 Vjetori”, Rruga “Koli Vesho” Berat

[Shqiptaria.com]